VENDIM
Nr. 154, datë 17.7.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "SPV BLUE 2" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d"; 39, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e" dhe 13, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1497/14 prot., datë 11.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SPV Blue 2' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1497 prot., datë 10.4.2025, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtim të energjisë elektrike, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1497/1 prot., datë 15.4.2025, ka depozituar mandatin për kryerjen e pagesës së aplikimit.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 84, datë 24.4.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.4.2025 dhe 2604.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 5.5.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 1496/4 prot., datë 30.4.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Pas korrespondencës së zhvilluar me ERE-n, në lidhje me plotësimin e informacionit/ dokumentacionit të munguar, dhe pasi ka rezultuar se është plotësuar një pjesë e këtij dokumentacioni, me *e-mail*-in e datës 15.5.2025, protokolluar në ERE me nr. 1497/6 prot., datë 19.5.2025, shoqëria ka kërkuar disa ditë kohë për depozitimin e dokumentacionit të mbetur ende pa plotësuar.
- Në këto rrethana, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 105, datë 23.5.2025, vendosi të zgjasë deri në 30 ditë afatin e vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1497/9 prot., datë 3.6.2025, rezulton se shoqëria ka dorëzuar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit, përmes shkresës së protokolluar me nr. 1497/8 prot., datë 3.6.2025, nga shqyrtimi i të cilit u vlerësua se mbetej ende për t'u sqaruar çështja e strukturës organizative dhe mbështetja financiare për ushtrimin e veprimtarisë.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 125, datë 24.6.2025, u vendos zgjatja e vendimmarrjes me 30 (tridhjetë) ditë, për t'i dhënë mundësi shoqërisë që të depozitojë këtë dokumentacion në ERE.
- Me shkresën nr. 1497/12 prot., datë 1.7.2025, u njoftua shoqëria për zhvillimin e një seance dëgjimore, për të sqaruar dokumentacion përkatës. Pas diskutimeve të zhvilluara në seancën e mbajtur

më datë 7.7.2025, në ambientet e ERE-s, me përfaqësuesin e shoqërisë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1497/13 prot., datë 7.7.2025, shoqëria ka depozituar dhe dokumentacionin e kërkuar.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Aneksi A i rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar.

- Në referencë të përcaktimeve të Rregullores, aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, pika 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; pika 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; pika 1.3, germat "a", "b" dhe "c"; si dhe pika 2.5.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "SPV Blue 2" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 2" sh.p.k., OST sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti